

AVANTAZHET

Pikat e forta të COOL-LITE KN 166 II janë: izolimi termik i avancuar, mbrojtje e shkëlqyer nga dielli dhe nivele të larta të trasmetimit të dritës. Humbja e nxehtësisë reduktohet drastikisht në dimër dhe gjatë verës do të shijoni komoditetin, sepse energjia diellore që do depërtojë në ambjentet e brendshme është shumë më e ulët. Në të njëjtën kohë përfitoni nga drita natyrore, duke siguruar një ambjent pune më të shëndetshëm dhe më ekonomik në kosto për kondicionim dhe ndriçim.

Në pamje të jashtme, xhami COOL-LITE KN 166 II si pjesë e ndërtesës, i jep fasadës personalitet, dinamizëm dhe elegancë.

COOL-LITE KN 166 II mund të kombinohet lehtësisht me lloje të tjerë xhamash për funksione shtesë si izolimi i zhurmave (me STADIP SILENCE), siguri (me STADIP ose STADIP PROTECT) etj.

NORMA DHE RREGULLORE

COOL-LITE KN 166 II përmbush Standartet European EN, class C,1096-1 dhe 1096-2.



SAINT-GOBAIN
CONSTRUCTION
PRODUCTS ALBANIA

Rr. Budull, Nr. 3 • 1039
Ahmetaq, Prezë
Vorë • Albania

Suport Teknik
Mob: +355 69 20 24 002
Mob: +355 67 70 17 770

COOL-LITE KN 166 II

KONTROLL DIELLOR DHE IZOLIM TERMIK PËR KOMODITETIN TUAJ

BUILDING GLASS



COOL-LITE KN 166 II

KONTROLL DIELLOR DHE IZOLIM TERMIK PËR KOMODITETIN TUAJ

PËRSHKRIMI

COOL-LITE KN 166 II është një xham selektiv me mbrojtje diellore të avancuar, i cili siguron jo vetëm izolim termik të shkëlqyer por gjithashtu nivele të larta të trasmetimit të dritës. Në pamje të jashtme, xhami është elegant, dinamik dhe ka një pamje gri në argjend, i përshtatet me lehtësi çdo ngjyre kornize apo muri. Në trasmetimin e dritës është neutral duke siguruar një ambjent shumë komod dhe të shëndetshëm.

COOL-LITE KN 166 II arrihet duke spërkatur mbi xhamin e qartë PLANICLEAR, me një proces spërkatjeje katodik nën vakum.

COOL-LITE KN 166 II 'për tu temperuar', duhet patjetër të trajtohet me nxehtësi (temperohet ose forcohet) para se të përdoret.



APLIKIMET

COOL-LITE KN 166 II është xham perfekt për të dyja aplikimet jo rezidenciale (zyra, dyqane, fasada) por është gjithashtu i përshtatshëm për aplikime në ndërtesa rezidenciale (shtëpi, vila, apartamente, mbyllje tarracash etj).

Falë pamjes elegante, ky xham përputhet në mënyrë perfekte me të gjitha llojet e dritareve, duke i dhënë ambjentit një pamje dalluese dhe dinamike njëkohësisht.



KAPACITETET E PËRPUNIMIT

- Xhama për izolim
COOL-LITE KN 166 II gjithmonë duhet të montohet në xham izolues duke parë kavitetin në faqen #2.
- Trajtim Termik
COOL-LITE KN 166 II duhet trajtuar me nxehtësi (temperohet ose forcohet) para se të vendoset në punë.
- Lakimi
COOL-LITE KN 166 II mund të lakohet brenda disa limiteve. Ju lutem konsultohuni me departamentin tonë teknik.
- Laminimi
COOL-LITE KN 166 II mund të laminohet me veshjen jo në kontakt me filmin PVB.
Shënim: COOL-LITE KN 166 II duhet të trajtohet me nxehtësi para laminimit



GAMA

Produkti	Trashësia [mm]	Dimensionet maksimale [mm]
COOL-LITE KN 166 II	6, 8, 10	6000 x 3210
COOL-LITE KN 466 II (*), (**)	6, 8, 10	

(*) - në variantin e xhamit PARSOL GREEN (**) sipas kërkesës

Të dhëna teknike				
	Transmetimi i dritës, LT [%]	Reflektimi i dritës, LR [%]	Faktori diellor, g	U [W/m².K]
6 mm COOL-LITE KN 166 II #2 16 mm Argon 4 mm PLANICLEAR	61	22	0.39	1.0
Në substrat jeshil 6 mm COOL-LITE KN 466 II #2 16 mm Argon 4 mm PLANICLEAR	49	16	0.26	1.0

